



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

AUTORITETI I KONKURENCËS

Nr. 8821 Prot., datë 20.12.2022

Nr. 736 Prot., datë 20.12.2022

UDHËRRËFYES I PËRBASHKËT

“PROKURIMI PUBLIK DHE MBROJTJA E KONKURENCËS, INTEGRITETI I PROCESIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 23, germa b) të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të nenit 70 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona të nënshkruar në Prill 2019 dhe duke synuar:

- ✓ Identifikimin e mënyrave dhe mjeteve për të adresuar rastet e marrëveshjeve të ndaluara në ofertat publike, për të rritur ndërgjegjësimin për minimizimin e praktikave anti-konkurruese të fshehta në tregjet e prokurimit;
- ✓ Ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për të përmirësuar njohuritë e përfaqësuesve të Autoriteteve Kontraktore, përgjegjës për prokurimet publike dhe mbështetje për Autoritetet Kontraktore për planifikimin e kujdesshëm të proceseve të prokurimit, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi me qëllim mirë-zbatimin e legjislacioneve respektive;
- ✓ Rritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative institucionale lidhur me njohuritë mbi tregun, procedurat për të inkurajuar maksimizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, kufizimin e riskut të marrëveshjeve të ndaluara në prokurime publike si dhe rritjen e ndërgjegjësimit, etj;
- ✓ Organizimin e tavolinave të diskutimit ndërgjegjësuere dhe trajnuese, ku përveç stafeve respektive të dy institucioneve, në fokus do të jenë edhe pjesëmarrja e Autoriteteve Kontraktore dhe operatorëve ekonomikë;
- ✓ APP dhe AK kanë hartuar këtë udhërrëfyes të përbashkët:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Prokurimi, është kryerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore me operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore.
2. Mbrojtja e konkurrencës në treg synon të mbrojë konkurrencën e lirë dhe efektive nga shtrembërimet, deformimet dhe kufizimet e ndërmarrjeve në treg.
3. Termi marrëveshje e ndaluar në prokurimin publik (i referuar edhe si "marrëveshje në oferta") i referohet marrëveshjeve të paligjshme ndërmjet operatorëve ekonomikë në procedurat e dhënies së kontratës publike, duke mos konkurruar midis tyre por rënë dakord fshehurazi për të rritur çmimet ose për të ulur cilësinë e mallrave ose shërbimeve për blerësit që dëshirojnë të prokurojnë produkte, shërbime ose punë nëpërmjet një procedure prokurimi apo duke rënë dakord të koordinojnë ofertat e tyre në prokurimet publike. Marrëveshje të tilla mund të marrin forma të ndryshme, si (i) ofertë e mbuluar, (ii) ofertë e përmbajtur, (iii) ofertë në rotacion dhe (iv) ndarje e tregut. Qëllimi i të gjitha këtyre praktikave, është t'i mundësojë një operatori ekonomik të paracaktuar të sigurojë një kontratë, duke krijuar përshtypjen se procedura është vërtet konkurruese.
4. Marrëveshja e ndaluar në prokurime publike dëmton një proces prokurimi të drejtë, transparent, të drejtuar nga konkurrenca, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe duke kufizuar zgjedhjen për blerësit publik. Në një proces prokurimi të prekur nga marrëveshjet e ndaluara në oferta, operatorët ekonomikë dekurajohen të marrin pjesë në procedurat përkatëse të dhënies së kontratës ose të investojnë në projekte të sektorit publik. Kjo ka një efekt veçanërisht të dëmshëm për kompanitë që kërkojnë ose kanë nevojë të zhvillojnë biznesin e tyre, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

II. PROKURIMI PUBLIK

5. Zbatimi i legjislacionit në fushën e prokurimeve publike ka për qëllim të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
6. Prokurimi publik është procesi i blerjes së punëve, mallrave ose shërbimeve nga sektori publik, qëllimi i të cilit është të sigurojë vlerën më të mirë për paratë publike. Prokurimi publik përfshin shpenzime të parave publike dhe duke pasur parasysh përmasat e tij, mund të ndikojë në strukturën dhe funksionimin e konkurrencës në një treg në

përgjithësi. Prandaj, është thelbësore të mbrohet integriteti i procesit të prokurimit publik, në mënyrë që të maksimizohen përfitimet që rezultojnë për shoqërinë dhe të mbrohen tregjet konkurruese.

7. Objektivi parësor i një politike prokurimi efektiv është promovimi i efikasitetit, pra zgjedhja e furnizuesit me cilësinë më të mirë për një çmim më të ulët ose, në përgjithësi, arritja e "vlerës për para" më të mirë.

III. POLITIKA E KONKURRENCËS

8. Marrëveshjet e ndaluara në oferta mund të ndodhin gjatë çdo procedure prokurimi. Vëllimi i madh i projekteve të prokurimit publik me vlerë të lartë – shumë prej të cilave lidhen me sektorë që historikisht kanë qenë të prirur ndaj sjelljeve anti-konkurruese – krijon mundësi tërheqëse për marrëveshje të ndaluara.
9. Fakti që prokurimi publik është veçanërisht i prekshëm ndaj ndërhyrjeve anti-konkurruese bëhet edhe më problematik duke patur parasysh se deformimi i procesit të prokurimit nëpërmjet marrëveshjeve të ndaluara ka një efekt veçanërisht të dëmshëm në sektorin publik.
10. Prokurimi publik është një çështje me rëndësi kyçe për zhvillimin ekonomik të një shteti, duke patur në konsideratë se: (i) mallrat dhe shërbimet e përfshira zakonisht prekin një pjesë të madhe të popullsisë; (ii) shpesh përfshin infrastrukturën fizike ose shëndetin publik, të cilat mbështesin forma të tjera të aktivitetit ekonomik; (iii) ndikon në konkurrencën ndërkombëtare; (iv) mund të ndikojë në klimën e investimeve; (v) shtrembërimi i prokurimit publik zakonisht ka ndikimin më të madh të dëmshëm tek më të pafavorizuarit në shoqëri dhe (vi) shpesh ka të bëjë me "të mirat publike".
11. Marrëveshjet e ndaluara në oferta mund të paraqiten në shumë forma, çdo njëra prej të cilave pengon përpjekjet e blerësve (Autoriteteve Kontraktore) për të siguruar produkte me çmimin më të ulët të mundshëm.
12. Oferta e mbuluar është forma më shpesh e përdorur, në të cilën gjenden të implementuara skemat e marrëveshjeve të ndaluara në oferta. Kjo ndodh atëherë kur operatorët ekonomikë, pranojnë të paraqesin oferta në një nga rastet e mëposhtme: a) njëri nga operatorët ekonomikë pranon të paraqesë një ofertë më të lartë sesa oferta e fituesit të përcaktuar; b) njëri nga operatorët ekonomikë pranon të ofertojë me një shumë e cila është shumë e madhe për tu pranuar si ofertë; c) njëri nga operatorët ekonomikë paraqet një ofertë e cila përmban terma specifike të cilat janë të papranueshme nga Autoriteti Kontraktor.

13. Oferta e përmbajtur përfshin marrëveshjen midis operatorëve ekonomikë në bazë të të cilës këta të fundit bien dakord që të mos ofertojnë apo të tërhiqen nga një ofertë e paraqitur në mënyrë që oferta e përcaktuar fituese në marrëveshje, të pranohet si e tillë.
14. Oferta në rotacion përfshin skemën sipas së cilës operatorët ekonomikë pranojnë të ofertojnë, por bien dakord të rrotullojnë të qenurit fitues.
15. Ndarja e tregut, ku operatorët ekonomikë ndajnë në copa tregun dhe bien dakord që të mos konkurrojnë në një pjesë të caktuar gjeografike.

III. AUTORITETET KONTRAKTORE - INTEGRITETI I PROCESIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

III.1. Në mënyrë që të pengohen marrëveshjet e ndaluara në oferta, gjatë procedurave të prokurimit publik është i rëndësishëm:

- ✓ Informacioni mbi tregun, specifikimet që mund të ofrohen, operatorët ekonomikë që janë aktivë në këtë sektor, çmimet që aplikohen në raste të ngjashme (si për prokurimet në sektorin publik të të njëjtit lloj), kostot e pritshme etj.
- ✓ Informacioni mbi koston reale të pritshme të tregut të shërbimit, mallit ose punës që do të tenderohet, që të kuptohet se sa të përshtatshme ose të arsyeshme janë ofertat ose nëse ka manipulime në çmimin e ofruar.
- ✓ Informacioni mbi prokurimet e mëparshme të natyrës së njëjtë ose të ngjashme.
- ✓ Informacioni lidhur me procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga Autoritete të tjera Kontraktore që kanë blerë së fundmi të njëjtin produkt ose shërbim dhe bazohuni në përvojën e tyre.
- ✓ Studim gjithëpërfshirës i tregut mbi çmimet e shërbimit ose produktit që do të prokurohet.
- ✓ Planifikimi dhe fillimi i procedurave të dhënies së kontratës mjaft herët, në mënyrë që të lihet koha e mjaftueshme për të vlerësuar siç duhet ofertat dhe për të adresuar rastet e dyshuara të marrëveshjes së fshehtë pa humbur afatet për përfundimin e procedurës.
- ✓ Organizimi dhe realizimi i procedurës së prokurimit publik në një mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen maksimale të operatorëve ekonomikë. Lehtësimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë rrit konkurrencën dhe minimizon rrezikun e pjesëmarrjes në marrëveshjeve të ndaluara në oferta.
- ✓ Shmangia, kur është e mundur, e parashikueshmërisë ose përsëritjes në procedurat e prokurimit. Edhe pse është e dobishme të informohet tregu paraprakisht për nevojat afatmesme dhe afatgjata, blerjet duhen organizuar me një shkallë të mjaftueshme diversiteti për sa i përket kohës, sasisë dhe buxhetit. Kjo e bën të vështirë për bashkëpunëtorët që të ndajnë tregun mes tyre në një mënyrë "të drejtë".
- ✓ Përcaktimi i specifikime teknike të qarta, të arsyeshme, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të kuptueshme dhe kritere përzgjedhjeje që janë në proporcion me punën, shërbimin ose mallin që do të prokurohet dhe që plotësojnë kërkesat përkatëse.

- ✓ Shmangia e termave që janë të panevojshëm, tepër të komplikuar, të parëndësishëm ose diskriminues (d.m.th. favorizimi ose disfavorizimi i operatorëve të caktuar), që kufizojnë konkurrencën dhe që, në fund, vënë në pikëpyetje objektivitetin e procedurës së dhënies së kontratës dhe besueshmërinë e Autoritetit Kontraktor.
- ✓ Përcaktimi i kriterëve të bazuara në cilësi sepse vlerësimi i ofertave në bazë të kriterëve të cilësisë vështirëson marrëveshjet e ndaluara në oferta, pasi rezultati i vlerësimit bëhet më i paparashikueshëm dhe nuk mund të manipulohet lehtë.
- ✓ Nëse është e mundur, gjetja e zgjidhjeve inovatore për nevojat tuaja. Pjesëmarrësit në marrëveshje të ndaluar në oferta, që zakonisht mbështeten në blerje publike të qëndrueshme dhe të parashikueshme, shpesh nuk mund të garantojnë ofrimin e shërbimeve ose furnizimeve inovative, ndryshe nga akotrët e rinj.
- ✓ Publikimi i informacionit dhe njoftimit të kontratës në mënyrë sa më të detajuar të jetë e mundur.
- ✓ Përfundimi i procedurës së prokurimit sa më shpejt të jetë e mundur, duke kufizuar në periudhën ndërmjet afatit të fundit për marrjen e ofertave dhe vendimit për dhënien e kontratës. Kjo inkurajon operatorët ekonomikë të marrin pjesë dhe, në të njëjtën kohë, kufizon kohën në dispozicion të ofertuesve për të arritur marrëveshje të ndaluar (siç është negociimi i tërheqjes së një ofertuesi nga procedura në këmbim të marrjes së një pjese të kontratës si nënkontraktor).

III.2. Këshilla se si të zbulohen marrëveshjet e ndaluara të mundshme gjatë vlerësimit të ofertave:

- ✓ Shqyrtimi i detajeve në ofertat e paraqitura gjatë procedurës së prokurimit. Shpesh marrëveshjet e ndaluara zbulohen nga detaje të vogla, të cilat zakonisht kalojnë pa u vënë re, por mund të jenë tregues se ofertat e caktuara janë përgatitur nga i njëjti individ ose janë koordinuar ndërmjet ofertuesve. Evidentimi i elementëve si:
 - Gabime identike ose drejtshkrimore në oferta të ndryshme.
 - Oferta të ndryshme të hartuara me lloj të ngjashëm të shkrimit.
 - Oferta ku përdoren koka e letrës ose detajet e kontaktit të një ofertuesi tjetër.
 - Oferta të ndryshme të cilat kanë të njëjtat llogaritje të gabuara ose të njëjtën metodologji për të vlerësuar koston e artikujve të caktuar.
 - Oferta të dorëzuara nga i njëjti individ ose individë që kanë të njëjtat detaje kontakti.
 - Përfshirja në ofertën e një operatori ekonomik, dokumentet e një operatori tjetër i cili konkurren në po të njëjtën procedurë.
- ✓ Shqyrtimi i ofertave që janë shumë më poshtë standardeve minimale të kërkuara nga dokumentet e tenderit, të paplota, ose që ofertohej nga një operator ekonomik i cili është dukshëm jo i aftë për të përmbushur kontratën. Oferta të tilla janë një tregues se mund të ketë një marrëveshje të ndaluar, në formën e "ofertës së mbuluar", për të manipuluar vlerësimin dhe për të arritur rezultatin e dëshiruar.

- ✓ Analizimi i çmimeve të ofruara nga operatorët ekonomikë, veçanërisht çmimet që nuk kanë kuptim sepse janë ose tepër të ulëta ose tepër të larta në krahasim me koston e parashikuar të kontratës, pa ndonjë shpjegim të qartë. Evidentoni:
- Tregues që ofertuesit mund të koordinojnë çmimet e tyre, të tilla si rritja e njëjtë e çmimeve që nuk mund të justifikohet me rritjen e kostos së tregut.
 - Diferencë të madhe ndërmjet çmimit të ofertës fituese dhe ofertave të tjera.
 - Nëse shumica e ofertuesve ofrojnë të njëjtin çmim.
 - Disa ofertues ofrojnë çmime shumë të ndryshme për procedura të ngjashme.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

16. Ky Udhërrëfyes hartohet në 2 (dy) kopje identike, ku 1 (një) kopje e mban Autoriteti i Konkurrencës dhe 1 (një) kopje Agjencia e Prokurimit Publik.
17. Çdo parashikim i këtij Udhërrëfyesi, që bie në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi në fushën e prokurimeve dhe konkurrencës, është i pavlefshëm.
18. Ky Udhërrëfyes nënshkruhet sot më datë 20/12/2022 dhe hyn në fuqi menjëherë.

PËR

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Znj. Reida KASHTA

Drejtor i Përgjithshëm



PËR

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Z. Denar BIBA

Kryetar

